



WATER AND WASTE REGULATORY OFFICE
ZYRA RREGULLATORE PËR UJË DHE MBETURINA
REGULATORNI URED ZA VODU I OTPAD

Raporti Pune për vitin 2008

Periudha Raportuese: janar 2008 – 31 dhjetor 2008

DEPARTAMENTI PER FINANCA DHE TARIF

Përpiloi: Sami Hasani

Tel: 038/249-165/ lok120

Mob: 044/155 -743

e-mail: sami.hasani@wwro.ks.org

Prishtinë, janar 2009

LISTA E SHKURTESAVE

- ZRRUM - Zyra Rregullatorë për Ujë dhe Mbeturina;
- DFT – Departamenti për Financa dhe Tarifa;
- OFCR/RFOK - Raporti Financiar, Operativ dhe Shërbimeve ndaj Konsumatorëve;
- AER – Agjencioni Evropian për Rindërtim dhe Zhvillim
- WICS - Water Industry Commission for Scotland
- SHUKOS - Shoqata e Ujësellsave të Kosovës;
- KLMC - Kompania për Menaxhimin e Deponive të Mbeturinave;
- KMDK – Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë
- KKK- Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve;
- AKM - Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit;
- KK - Kuvendi Komunal;
- IPA-Projekti mbështetës për ZRRUM i financuar nga Agjencioni Evropian për Rindërtim;
- BM – Bordet Menaxhuese
- BMK – Bordet Manxhuese të Kompanive
- MEF- Ministria e Ekonomisë dhe Financave;
- MMPH - Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë;
- MAPL - Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal;
- SHUKALB - Shoqata e Ujësellsve dhe Kanalizimeve të Shqipërisë;
- ERRU - Enti Rregullator i Ujit të Shqipërisë;
- OEK- Oda Ekonomike e Kosovës;
- KUR - Kompanitë e Ujësellsit Regjionale;
- KRM - Kompanitë Regjionale të Mbeturinave;
- UTSH – Urdhëresa Tarifore të Shërbimeve

PËRMBAJTJA

1.	Hyrje	4
2.	Përgjegjësitë e DFT`s	6
3.	Aktivitetet e ndërmarra për realizmin e detyrave të punës	8
3.1	Faza përgatitore për procesin tariforë	8
3.2	Faza e ndërmjetme për punët që nuk janë lidhura me procesin tariforë	9
3.3	Faza realizuese e procesit tariforë	10
3.4	Faza realizuese – kontaktuese me KUR`ët dhe KRM`ët	10
3.4.1.	Komentet e Kur`ve	11
3.4.2	Përcaktimet e tarifave të sistemeve të ujësjellësit dhe kanalizimit	11
3.5	Aktivitete të tjera	12
3.6.	Pasqyrimet i angazhimit të personelit të DFT`s në formë tabelore për gjatë vitit kalendarik 2008	12

Shtojca Nr. 1: Angazhimi dhe punët e përfunduar nga safi i DFT`s gjatë vitit
kalendarik 2008

1. HYRJE

Ky raport përshkruan aktivitete, angazhimet dhe punët e kryera nga Departamenti për Financa dhe Tarifa në ZRRUM-it, gjatë vitit 2008, duke filluar nga 3 janari dhe përfunduar me 31 dhjetor të njëjtit vit.

Në kuadër të ZRRUM-it vepron Departamenti i Financave dhe Tarifave, detyrë primare e të cilit është përcaktimi i tarifave për Kompanitë Ujësjetësve Regjionale dhe Kanalizimit; për Ndërmarrjen Hidroekonomike "Ibër-Lepenc" Sh. A. Prishtinë; Kompanitë Regjionale të Grumbullimit të Mbeturinave dhe Kompaninë për Menaxhimin e Deponive në Kosovë.

Aktiviteti i angazhimit të DFT-ës është përqendrua në;

- (i) konsultimet me të gjitha kompanitë për procedurat, afate e fillimeve dhe të përfundimeve të proceseve tarifore,
- (ii) metodologjinë e përcaktimit të tarifave
- (iii) harmonizimin e dokumentacionit dhe afateve të fillimit dhe përmbylljes së afatit të përcaktimit të tarifave,
- (iv) përgatitjen e dokumentacionit dhe përgatitjen e ftesave dhe dokumentacionit tjetër për aplikim,
- (v) pranimin e dokumentacionit për aplikim,
- (vi) konfirmimin e pranimin të aplikacionit dhe vlerësimin e kompletshmerisë administrative
- (vii) vlerësimin e parë të dhënave operativo – financiare,
- (viii) mbajtja kontakteve të rregullta dhe të shpeshtë me kompanitë,
- (ix) përpilimi raporteve dhe dokumenteve tjera,
- (x) nxjerrja e Urdhërësive Tarifore për Shërbime,
- (xi) monitorimi i efekteve të tarifave të përcaktuara,
- (xii) analiza e pasqyrave financiare dhe dokumenteve tjera krahasuese të vendit dhe të jashtëme për të gjitha kompanitë,
- (xiii) përcjellja e tregueseve makroekonomik te vendit etj.

Në cilësinë e Rregullatorit Ekonomik, objektivë kryesorë i DFT`ës ka qenë;

- komunikimi për marrjen e opinioneve për realizimin e procesit tarifor 2009/11,
- përgatitjen për realizimin e vet procesit tarifor,
- fillimin,
- udhëheqjen,

- realizimin - ekzekutimin,
- monitorimin e proceseve të ndërlidhura me procesin tariforë

Këto procese janë të lidhura ngushtë me aktet legjislative, në bazë të cilave ZRRUM`i vepron dhe punon, dhënien e udhëzimeve të ndryshme, marrjen e asistencës për nevoja të veta dhe ofrimin e të njëjtës tek kompanitë e licencuara.

Këto angazhime DFT`i realizon duke u mbështet në;

- të dhënat historike (operative dhe financiare),
- në planet sektoriale të shërbimeve përkatëse dhe në planet individuale të kompanive veç e veç,
- në krahasimin e të dhënave nga një periudhë te tjetra,
- përshtatjen e modeleve softuerike për realizim te proceseve te nevojshme,
- në hulumtimin e të dhënave jashtme të cilat e ndihmojnë procesin
- përpilimin e dokumenteve të ndryshme për nevoja të brendshme dhe të jashtme etj.

Përmbajtja e këtij raporti ndahet në tri pjesë:

- Përgjegjësitë e DFT`s,
- Aktivitete e ndërmarra për realizim të detyrave të punës, dhe
- Punët e kryera

Bashkangjitur si shtojcë është dhënë plani dinamik i aktiviteteve dhe punëve të kryera:

- Plani dinamik i aktiviteteve dhe realizimi i punëve

2. PËRGJEGJËSITË E DFT`S

Përgjegjësia e DFT`s është e madhe dhe shumë komplekse e cila kërkon staf të mjaftueshëm dhe mirë të kualifikuar i cili në rastin tonë mund të thuhet se nuk ka qenë i mjaftueshëm, i përkushtuar për zbatim të politikave dhe të proceseve të cilat duhet të zhvillohen gjatë vlerësimeve të aplikacioneve. Stafin duhet ta karakterizojnë njohurit shumë dimensionale e specifike, të cilat janë mase të domosdoshme, për përmbylljen me sukses të proceseve të përcaktimit të tarifave.

Roli kryesor i Departament të Financave dhe Tarifave është organizimi i;

- (i) procesit para aplikativë,
- (ii) aplikativë, dhe
- (iii) pas aplikativë.

Në kuadër të këtyre aktiviteteve ky departament ka për detyrë të;

- (i) mbajtjen e kontakteve me të gjitha kompanitë për udhëheqjen e proceseve tarifore,
- (ii) kujdeset për materiale dhe ofrimin instruksioneve tjera të nevojshme për realizim të procesin tariforë,
- (iii) pranimin e aplikacionit dhe dokumentacionit tjetër të ndërlidhur me proces,
- (iv) konfirmimin e pranimin të aplikacioneve,
- (v) analizimin e të gjitha dokumenteve të pranuar dhe të tjera dhe vlerësimin e tyre sipas kriterëve të përcaktuara nga ZRRUM`i,
- (vi) kontaktimi dhe komunikimi i kompanive në grup dhe veç e veç,
- (vii) pranimin e komenteve nga kompanitë,
- (viii) vlerësimi përfundimtarë i të dhënave të raportuara të kompanive,
- (ix) pritjen e komenteve përfundimtare,
- (x) përgatitjen dhe dërgesa e UTSh`ve etj.

Pas përfundimit të aktiviteteve dhe punëve të lartë cekura, përgjegjësi primare e DFT`s mbetet procesi i monitorimit të;

- (i) efekteve të dala nga tarifat e përcaktuara,
- (ii) analiza dhe vlerësimi i treguesve operativë dhe ekonomik-financiare,
- (iii) inspektimet e realizimeve të projekteve investive,
- (iv) përpilimin e informatave dhe raporteve të caktuar kohore,

- (v) ndërmarrjen e veprimeve për ndërhyrje eventuale për të ngritë efektshmerinë e shërbimeve dhe rrjedhën financiare etj.

Procesi i përcaktimit të tarifave është shumë dimensional dhe mjaft kompleks e i ndërlikuar i cili kërkon gjykim të drejt dhe vizion kohorë afat mesëm dhe afat gjatë, të cilit duhet në çdo kohë të përshtaten gjithnjë me të arriturat e reja ekonomiko-financiare dhe teknike, për çka kërkohet të:

- Organizoj dhe mbledh të dhëna financiare dhe tekniko operative nga të gjitha kompanitë që i janë nënshtrua procesit tariforë, nga aspekti i realizimit të planeve biznesore të aprovuara nga BM`ët dhe ZRRUM`i,
- Marr pjesë në këshillime, punëtori dhe seminare me tematikë të tarifave dhe investimeve në sektorin e ujit dhe mbeturinave,
- Rishikoj dhe rivlerësoj të gjitha të dhënat e aprovuara nga ZRRUM`i,
- Ruaj integritetin e të dhënave,
- Të bëj publike vendimet e veta në forma të ndryshme, për të dëshmuar transparencën e vet si organ publik dhe i pa anshëm,
- Përshtatë dhe zhvilloj metoda të avancuara për realizim të proceseve të tarifore dhe monitorimin e tyre,
- Përpilojë raporte për çdo proces të udhëhequr,
- Të veprojë gjithnjë në harmoni me aktet rregullative të këtij sektori dhe në mënyrë specifike për procesin tariforë dhe atë investive, etj.

DFT në çdo kohë mban komunikim të mirë dhe të ndërsjellë me kompanitë e licencuara me qëllim të përcjelljes së trendëve dhe lëvizjet e treguesve operativë financiarë dhe teknik; merr sugjerimi nga to dhe të tjerët për avancim të proceseve dhe futë kategori të reja ekonomike dhe teknike në sistemin e përlllogaritjeve të tarifave të cilat e ndihmojnë procesin etj.

3. Aktivitetet e ndërmarra për realizimin e detyrave të punës

3.1 Faza përgatitore për procesin tariforë

Obligim i primarë i DFT`s në këtë fazë ka qenë përgatitja e stafit të brendshëm, stafit menxherial të kompanive dhe palëve të tjera për realizim të procesit të rij tariforë 2009 – 2011:

- (i) Diskutimet për politikat dhe metodologjinë e përcaktimit të tarifave të ujit,
- (ii) Marrjen e miratimit për politikat e përcaktuar nga palët e interesuara,
- (iii) Angazhimi në përcaktimin e akteve legjislative,
- (iv) Formulimi dhe nxjerrja e procedurave për udhëheqjen e procesit tariforë,
- (v) Zhvillimin e modeleve softuerike për realizim të procesit tariforë,
- (vi) Përshtatjet të pjeshme të modeleve softuerika të çfaqura ndërkohë gjatë zhvillimit të procesit tariforë me asistim për përdorim të tyre etj.

DFT/ZRRUM për realizimin dhe udhëheqjen e këtij procesi tariforë ka qenë angazhuar edhe gjatë vitit 2007.

Angazhimin e vetë DFT`ja e ka fillua që nga kuartali i dytë i vitit 2007, me ndihmën edhe të konsultanteve ndërkombëtarë të angazhuar nga firma konsulente IPA në cilësinë kontraktuesit të AER`it.

Punëtorit (Workshopet) e para janë mbajtur me 15 maj dhe 12 dhjetor 2007 për diskutim të politikave dhe metodologjive të reja të përcaktimit të tarifave të ujit dhe me 17 maj e 24 korrik të vitit 2007 për të njëjtin qëllim për kompanitë e mbeturinave.

Gjatë vitit 2008 me punëtorit e mbajtura me 3 mars dhe me 27 gusht është përmbyll cikli i tyre dhe është angazhuar i tërë potenciali për analiza dhe vlerësim të aplikacioneve të sektorit të ujit dhe kanalizimit, furnizimin ujit me shumicë të pa trajtuar dhe atë të trajtuar.

Një punëtori tjetër për çështje organizative dhe funksionale të tërë stafit të zyrës sonë është mbajtur gjatë fundit të marsit 2008 në Ohër.

Gjatë fundit të muajt Maj 2008 në Grupin Studimorë për vizitë WICS kam qenë edhe unë, ku jemi informuar për mënyrën e funksionimit dhe politikat që i ka udhëheq ky institucion i pavarur i Skotlandes.

Si aktivitet duhet përmend edhe pjesëmarrjen në Konferencën Vjetore të Shoqatës së Ujësjetësve të Shqipërisë në Tiranë dhe vizitën e ekspozitës së organizuar nga partneret afarist të kësaj shoqate.

Në këtë fazë duhet numërua edhe procesin e përcaktimit të tarifave për kompanitë që merren me shërbimet e grumbullimit të mbeturinave dhe asaj të deponimit të përhershëm sanitarë të tyre.

Gjatë kësaj faze duhet theksua edhe faktin se në bashkëpunim me konsultatët ndërkombëtarë, jemi akordua për mbajtjen e dy proceseve tarifore për të njëjtin qellim, njeri ka qenë;

- (i) procesi përgatitorë – paraprakë testues, dhe tjetri
- (ii) i rregullt dhe përfundimtarë

3.2 Faza ndërmjetme për punët që nuk janë lidhura me procesin tariforë

Si punë të ndërmjetme në mes dy proceseve tarifore duhet përmend angazhimin e DFT`s për;

- (iii) sistemin e dokumentacionit të mbledhur gjatë vitit 2007 në regjistratorë dhe në formë,
- (iv) hapjen e dosjeve dhe regjistratorëve të rijë për vitin 2008,
- (v) përgatitjen dhe dorëzimin e planit të punës për vitin 2008 për DFT`n,
- (vi) gjatë fund vitit 2007 dhe fillim vitit 2008 kemi punua në proces të përcaktimit të tarifave për KMDK /KLMC`ën dhe tarifën e ujit me shumicë të trajtuar për Mitrovicën e Veriut,
- (vii) është punua në përpilimin e Raportit Përmbledhës për procesin e realizuar tariforë të KRM`ëve,
- (viii) është përcaktua e tarifa e ujit me shumicë të trajtuar për Mitrovicën e Veriut,
- (ix) një person i DFT`s ka qenë pjesëmarrës i procesit të auditimit të dhënave të deklaruar për vitin 2007 gjatë vizitave të bërë në KUR`ët dhe KRM`ët,
- (x) është përcaktua e tarifa për deponimin e përhershëm sanitarë të mbeturinave në deponit e menaxhuara nga KMDK /KLMC`s,
- (xi) është rekrutua një Analist për Asete,
- (xii) është përgatit dhe dorëzua vlerësimi për punën e konsultative gjatë angazhimit të tyre etj.

Në këtë hapësirë duhet përmend edhe Vendimet e marra në ZRRUM për zgjatjen e afateve të tarifave ekzistuese për të gjitha KUR`ët nga 1 gushti 2008 gjer me 31 dhjetor 2008, për NH “Ibër-Lepenc” Sh. A. Prishtinë nga 1 shtatori

2008 gjer me 31 dhjetor 2008, për KRM`ët nga 1 tetori 2008 gjer me 31 dhjetor 2008 etj.

3.3 Faza realizuese e procesit tariforë

Në këtë fazë janë bërë përgatitjet e përgjithshme administrative për realizim të procesit tariforë në të cilin duhet numërua;

- (xiii) publikimin dhe dërgimin e procedurave të reja të politikës së re tarifore të kompanitë që merren me shërbimet e ujësjelljes dhe ato të shërbimeve të kanalizimit,
- (xiv) zhvillimin, formatizimin dhe zgjidhjen e modeleve të reja softëuueike për realizim të këtij procesi,
- (xv) asistimi dhe demonstrimi i tyre si tërësi dhe veç e veç nëpër kompani,
- (xvi) pranimi i aplikacioneve dhe dokumentacionit tjetër përcjellës,
- (xvii) konfirmim pranimi dhe vlerësimi preliminarë i të dhënave të dërguara,
- (xviii) marrja e komenteve nga KUR`ët,
- (xix) analiza dhe vlerësimi përfundimtarë për përcaktim të tarifave,
- (xx) marrja e komenteve përfundimtare nga kompanitë,
- (xxi) përcaktimi i tarifave për çdo kompani veç e veç etj.

3.4 Faza realizuese – kontaktuese me KUR`ët dhe KRM`ët

Kontaktet tona me kompanitë e ujësjellësve dhe kanalizimeve dhe ato të mbeturinave. Ato janë intensifikua sidomos me kompanitë e ujësjellësve dhe kanalizimeve qysh nga procesi paraprak testues tariforë, pastaj hapjes së fazës së rregullt aplikative dhe pranimi të dhënave të tyre. Për KUR`ët afati i fundit për aplikim ka qenë 30 qershor dhe për KRM`ët ka qenë 15 korrik 2008. Të dy proceset tarifore janë zhvillua paralelisht duke i dhënë përparësi procesit tariforë për KUR`të.

Për të dy sektorët janë përgatit dhe dërgua Raportet, me të cilat janë konfirmua pranimet e aplikacioneve dhe për shkurtim të procedurave janë bërë edhe vlerësimet preliminare për të dhënat e raportuara me të njëjtin dokument. Që të gjitha këto procedura janë krye në afatin kohorë prej 15 ditëve nga dita e pranimi zyrtarë të aplikacioneve, me përjashtim të rasteve ku kompanitë vetë i kanë qenë shkaktare të vonesave.

Pas këtyre veprimeve DFT ka pritë komentet e kompanive dhe ka fillua fazën e konsultimeve të serishme dhe vlerësimin përfundimtarë të aplikacioneve dhe të dhënave për kompanitë që ofrojnë shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit.

Ndërsa, për kompanitë e grumbullimit të mbeturinave procesi i vlerësimit përfunduar ka ngel i pa përmbyllur, pasi që në ZRRUM është vlerësua se duhet bërë harmonizimin kohorë të tarifave të tyre, me tarifat e KMDK/KLMC`s të cilat e kanë vlefshmërinë gjerë me 31 maj 2009. Arsye e vetme ka qenë harmonizimi kohorë pasi që tarifat e KMDK/KLMC ndikojnë të shumica e kompanive tjera të grumbullimit të mbeturinave.

3.4.1. Komentet e Kur`ve

Pas çdo Raporti të lëshuar nga DFT/ZRRUM u është dhëna afati kohorë kompanive të shërbimeve të ujësjellësve dhe kanalizimeve për të komentua të njëjtat dhe me ofrua kundërshtimet për to, por kjo fatkeqësisht nuk është shfrytëzua sa dhe si duhet.

Në vazhden e këtij angazhimi janë mbajtur kontakte intensive me përfaqësuesit e të gjitha kompanive, nga disa herë radhazi dhe nga to kemi arrit të faza kur kemi marrë vendime për përcaktim të tarifave të këtij cikli tariforë për sektorin e ujit.

Te KRM`ët ky proces ka mbet për arsyet e theksuara te pika 3.4. Faza realizuese - kontaktuese me KUR`ët dhe KRM`ët, paragrafi i fundit.

Nga propozimet e para të DFT`ës nuk ka pas shumë komente të kompanive, me përjashtim të KUR "Hidromorava" Sh. A. Gjilan, e cila të dhënat e veta i ka deklarua shumë herë, në të cilat ka pas hamendje, jo-konsistencë, shmangie nga të dhënat historike, plane jo shumë të bazuara operative, financiare e investive etj.

3.4.2. Përcaktimet e tarifave të sistemeve të ujësjellësit dhe kanalizimit

Pas analizave të gjata dhe komenteve të ndërsjella DFT ka ardhë në përfundim me propozimin e bërë për tarifat e këtij procesi, të cilat do të zgjasin tri vite, vit pas viti duke fillua nga fillim vitit 2009 dhe gjer në fund të vitit 2011 me mundësi të rishikimit çdo herë kur për të njëjtat krijohen rrethanat e domosdoshme..

Tarifat e përcaktuara janë ngrit relativisht pak në krahasim me tarifat ekzistuese Ngritjet m,mesatare e tarifave volumetrike për të dy shërbimet është sjellë nga 0,01 €/m³ në rastin e "Hidrodrinit" deri në 0,05 €/m³ në rastin e Hidromoravaes".

Kjo ngritje e tarifave është pasua pas tri viteve të tarifave të pa ndryshuara, me përjashtim të rastit të tarifave të “Hidroregjionit Jugor” dhe ato të “Hidrodrinit” të cilat simbolikisht kanë pësua ngritje në gjatë procesit tariforë 2007/08.

Politikat e këtij procesi tariforë dhe aktet tjera rregullative i kanë mundësua DFT/ZRRUM të përcaktojë tarifatat duke u mbështetur në;

- a) të dhënat operative,
- b) të dhënat financiare,
- c) ndikimin e faktorëve të jashtëm,
- d) marrja në konsideratë të kategorive të reja ekonomike sikurse që janë;
 - (i) vlerësimin e aseteve nga aspekti rregullatorë;
 - (ii) pranimin e një pjese të llogarive të arkëtueshme të pa mbledhshmi;
 - (iii) pranimin e shkalles së amortizimit për asetet jo-infrastrukturore;
 - (iv) llogaritje e normës së kthimit në kapital;
 - (v) faktorët e jashtëm ndikues etj.

Urdhëresat e para DFT/ZRRUM i ka përgatit para fundit të vitit 2008 dhe në mënyrë simbolike është vendosë data 31 dhjetor 2008, të cilat janë dërgua në kompaninë fillimisht me post elektronike dhe pastaj me post të rregullt me 5 janar 2009, me përjashtim të KUR “Hidromorava” Sh. A. Gjilan të cilës i është dërgua urdhëresa e tillë me 14 janar 2009, për shkaqe objektive të theksuara ma lartë.

DFT/ZRRUM në marrëveshje me KUR “Bifurkacioni” Sh. A. Ferizaj ka zgjatë afatin e vlefshmërisë së tarifave ekzistuese për katër zona rurale të cilat i ka nën neaxhim të saj dhe ate gjer me 31 dhjetor 2009, pasi që është akordua mendimi se nuk ka ndryshua ndonjë rrethanë për përcaktim të rij të tarifave të këtyre lokaliteteve.

3.5 Aktivitete të tjera

Për përmbushjen e objektivave të punës duhet përmend edhe një mori aktivitete të cilat janë zhvillua para vendosjes përfundimtare të tarifave, në të cilat kanë qenë të angazhuar personeli DFT`ës me që rast po përmendim;

- (i) takimin me kryetarët e këshillave të konsumatorëve në ZRRUM,

- (ii) takimin me të gjitha këshillat e konsumatorëve në qendrat regjionale ku kompanitë e kanë selinë, ku janë dhëna arsyetimet rreth procesit të zhvilluar tariforë dhe ku janë marrë mendimet e tyre për propozimet e tarifave të reja dhe ku janë diskutua edhe planet investive,
- (iii) kolegët e zyrës kanë vijua kurset e trajnimit për gjuhën angleze, kontabilitetit dhe ngritjen profesionale të shkallës Master,
- (iv) kemi marrë pjesë edhe në çdo manifestim të organizuar nga ZRRUM`i,
- (v) është asistua Departamenti i Përformances në ZRRUM me rastin e auditimeve të bëra për të dhënat e deklaruar të KUR`ve dhe KRM`ve etj.

3.7 Pasqyrimet e angazhimit të personelit të DFT`s në formë tabelore për gjatë vitit kalendarik 2008

Puna e këtij departamenti është realizua si punë ekipore e sistemuar qartë dhe me produkte finale të cilat janë përshkrua në këtë Raport të dala si rezultat i angazhimit të gjithë të punësuarave, duke mos harrua me e vlerësua edhe punën e shërbimeve tjera përcjellëse në ZRRUM dhe strukturën udhëheqëse të tij të cilat e kanë ndihmua dhe lehtësua angazhimin tonë dhe përmbylljen me sukses të vitit punues 2008.

Për të vëzhgua angazhimin dhe punën e të punësuarve të DFT`ës po i prezantojmë të njëjtat në formë grafike, muaj pas muaj gjatë vitit të kaluar kalendarik për krijimin e një përshtypje të kartë.

Në vijmë do të njiheni me Shtojcën Nr. 1., e cila pasqyron angazhimin dhe punën e këtij departamenti në formë grafike:

Shtojca Nr. 1: Angazhimi dhe punët e përfunduar nga safi i DFT`s gjatë vitit kalendarik 2008

PLANI ANGAZHIMIT DHE REALIZIMIT TË AKTIVITETEVE TË PENUËS GJATË VITIT 2008

Aktivitetet Kryesore		Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
2.1 Punët përmbyllëse të vitit 2007													
2.1.1	Selektimi, sistemimi dhe fajllimi i dosjeve të vitit 2007												
2.1.2	Hapja e dosjeve dhe fajlleve për punët e vitit 2008												
2.1.3	Është punua në shembullin e procesit tariforë 2009/11												
2.1.4	Është përgatit Raporti vjetor i punës për vitin 2007												
2.1.5	Është punua Raporti Përfund. për shërbimet e ujit 2007/08												
2.1.6	Është Punua Raporti përfund. për shërb. e mbetur. 2007/08												
2.1.7	Është përgatit plani i punës për vitin 2008												
3.2 Punët përgatitore rreth procesit tariforë 2009-11													
3.2.1	Mbajtja e tri punëtorive me kompanitë regjionale												
3.2.2	Pjesëmarrje në ekipin realizues të auditimit												
3.2.3	Bashkëpunimi i ngushtë me ekipin e konsulentëve ndërkom.												
3.2.4	Përgatitja e Softuerëve për procesin tariforë												
3.2.5	Përcaktimi i politikave dhe metodologj. për procesin tariforë												
3.2.6	Përshtatja e rregullores për përcaktim të tarifave ujë/mbet.												
3.2.7	Marrja e miratimit nga kompanitë për metodologji. e tarifave												
3.2.8	Publikimi i procedurave të politikave të reja tarifore												
3.2.9	Aftësimi i stafit vend. për aplikim të mod. të reja Softuerike												
3.2.10	Asistimi i kompanive për punë në modelet softuerike												
3.2.11	Është vlerësua kontrib. i një konsulenti ndërkomb. Z. Bernd												
3.2.12	Trajnim i stafit të ZRRUM`it në Ohër												
3.2.13	Vizitë studimore në WICS Edinburgha/Scotland												
3.2.14	Pjesëmarrje në Konferencën e Ujit,Tiranë/Shqipëri												

3.2 Analiza, përpunimi dhe vlerësimi i të dhënave të raportuara													
3.2.1	Përcaktimi i tarifës për ujë me shumicë në KUR "Mitrovica"												
3.2.2	Përcaktimi i tarifës për KMDK/KLMC												
3.2.3	Është hap procesi testues për tarifa shërbimi 2009-11												
3.2.4	Janë dërgua ftesat për aplikim të KUR`e për të dy proceset												
3.2.5	Janë dërgua ftesat për aplikim për tarifa e KRM`ëve												
3.2.6	Pranimi i aplikacioneve të KUR`ëve												
3.2.7	Pranimi i aplikacioneve të KRM`ëve												
3.2.8	Dërgesa e konf. për pranim dhe vlerës.preliminarë KUR`ëve												
3.2.9	Dërgesa e konf. për pranim dhe vlerës.preliminarë KRM`ëve												
3.2.10	Pranimi i komenteve nga KUR`ët për konf. dhe vlerësim												
3.2.11	Pranimi i komenteve nga KRM`ëve për konf. dhe vlerësim												
3.2.12	Komunikimi i ndërsjellë me sektorin e ujit për këtë fazë												
3.2.13	Komunikimi i ndërsjellë me sektorin e mbet. për këtë fazë												
3.2.14	Përpilimi i Raporteve Përfundimtare të Vlerës. për KUR`ët												
3.2.15	Marrjen e komenteve nga kompanitë e KUR`ëve												
3.3 Faza përmbyllëse e procesit taritorë për shërbime e ujësjellësve dhe kanalizimeve 2009 - 2011													
3.3.1	Diskut. në ZRRUM për marrjen e vendime. për tarifën e ujit												
3.3.2	Përgatitja e UTSH`ëve për shërbimet e ujit												
3.3.3	Dërgesa e raporteve dhe shkresave të publikua. nga ZRRUM												
3.3.4	Komentet specifike të KUR "Hidromorava" Sh. A. Gjilan												
3.4 Punëtorit (Workshopet)													
3.4.1	Punëtorja zgjidhja e shembullit praktik për tarifa shërbimi 2009 - 11												
3.4.2	Punëtorja Menasxhimi i aseteve të KUR`ve												
3.4.3	Punëtorja interne për përdorim të softuerëve												
3.4.4	Punëtorja interne për përdorim të Rap. Vjet..softuerëve												
3.4.5	Demonstrim të funksionit të softuerëve në KUR`ët												
3.4.6	Demonstrim të funksionit të softuerëve të KRM`ve												

3.5 Pjesmarrja ne Konferenca dhe Vizita studimore													
3.5.1	Trajnim i stafit të ZRRUM`it në Ohër/Maqedoni												
3.5.2	Vizitë studimore në WICS Edinburgh/Skotland												
3.5.3	Konferencë vjetor ditët e ujit Tiranë/Shqipëri												
3.6 Takime me Kompanitë													
3.6.1	Takime të rregullta me përfaqësuesit e KUR`ve												
3.6.2	Takime të rregullta me përfaqësuesit e KRM`ve												
3.6.3	Takim me Kryetarët e Këshillave të Konsumatorëve												
3.6.4	Takimet me të gjitha KKK në selit e kompanive												
3.7 Inspektimet													
3.7.1	Inspektimi i KUR Mitrovica për tarifë me shumicë												
3.7.2	Inspektimi i KUR Hidromorava Gjilan												
3.7.3	Inspektimi i të dhënave të KLMC`s												